

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive,, për pozicionin:

1 (një) Specialist i IT-së, në Sektorin e Shërbimeve Administrative në Drejtorinë e Shërbimeve të Mirëmbajtjes (Kategoria e pagës III-b)

PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Pozicioni i mësipërm i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e Lëvizjes Paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së Lëvizjes Paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, atëherë ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet Procedurës së Ngritjes në Detyrë.

Afati për aplikimi për Lëvizje Paralele është deri në datë: 16.08.2019

Afati për aplikim për Pranim në Shërbimin Civil është deri në datë: 21.08.2019

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin.

1. Menaxhimi, mirëmbajtja dhe përpunimi i informacionit nëpërmjet programeve që ka në zotërim KLP,
2. Administrimi dhe ruajtja e bazave të të dhënave, përcaktimi dhe krijimi i strukturave funksionale për përdorimin afatgjatë të programeve si dhe realizimi i përshtatjeve të ndryshme në program për të përmirësuar regjistrimin, trajtimin dhe nxjerrjen e informacionit.
3. Menaxhimi, administrimi, mirëmbajtja e rrjetit kompjuterik, kompjuterave, printerave, kamerave apo aparateve të tjera elektronike si dhe administrimi dhe mirëmbajtja e rrjetit telefonik.
4. Menaxhimi, administrimi, mirëmbajtja e serverave si dhe asistence teknike për kompjuterat dhe rrjetin.
5. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave dhe statistikave për Raportet e ndryshme të Institucionit.
6. Trajnimi i vazhdueshëm i stafit në lidhje me përdorimin e programeve.
7. Të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për përgatitjen e seancave plenare dhe të sigurojë mbështetje për Kryetarin dhe anëtarët e KLP për mbarëvajtjen e procedurave.

I. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm Nëpunësit Civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet, pjesë e Shërbimit Civil.

Kushtet për Lëvizjen Paralele dhe kriteret e veçanta për pozicionin

Kandidati për Lëvizjen Paralele duhet të plotësojë kushtet si më poshtë vijon:

1. Të jetë nëpunës Civil i konfirmuar, brënda së njëjtës kategori (Kategoria IV-a/III-b).
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument të lëshuar nga institucioni);
3. Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv “Shumë Mirë” ose “Mirë”.

Kriteret e Veçanta

1. Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Profesional” në degën Inxhinieri Elektronike/ Informatike.
2. Të ketë të paktën **2 vite** eksperiencë pune në fushën e kërkuar.
3. Preferohet të zotërojnë të paktën një certifikatë për sistemet operative, administrim rrjetesh, data base etj.
4. Të ketë njohuri të gjuhës angleze.

2. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë vijojnë:

1. Jetëshkrim të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të cilin e gjeni në link: <http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard;>
2. Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të Gjendjes Shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të Gjendjes Gjyqësore;
7. Vlerësimin e fundit në punë;
8. Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.
9. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
10. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Këshillin e Lartë të Prokurorisë brenda datës 16.08.2019.

3. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Drejtoria e Burimeve Njerëzore në KLP do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Lëvizjes Paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e Lëvizjes Paralele të përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të njoftohen në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës së e-mail.

4. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët që konkurojnë do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
2. Njohuri mbi Ligjin nr.10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
3. Njohuri mbi Ligjin nr.10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar;
4. Njohuri mbi Ligjin nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
5. Njohuri mbi legjislacionin për krimin kibernetik (eëë.akshi.gov.al/Legjislacioni).
6. Rregullore për përdorimin e postës elektronike në administratën publike.
7. Legjislacioni në fuqi në lidhje me sigurinë e informacionit (<https://cesk.gov.al/legjislacioni/index.html>)

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

Vlerësimi i dokumentacionit:

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, përvojën, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e punës, sipas fushës së njohurive;
2. Eksperiencat e tyre të mëparshme;
3. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve do të shpallet fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në faqen zyrtare të Institucionit. Të gjithë kandidatët pjesmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

III-Pranimi në Shërbimin Civil

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpallje, në përfundim të Procedurës së Lëvizjes Paralele rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet Procedurës së Pranimit në Shërbimin Civil. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të popullit, duke filluar **nga data 22.08.2019**

1. Kushtet dhe kriteret e veçanta për Pranim në Shërbimin Civil:

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të Shërbimit Civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të Ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

1. Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Profesional” në degën Inxhinieri Elektronike/ Informatike.
2. Të ketë të paktën **2 vite** eksperiencë pune në fushën e kërkuar.
3. Preferohet të zotërojnë të paktën një certifikatë për sistemet operative, administrim rrjetesh, data base etj.
4. Të ketë njohuri të gjuhës angleze.

2. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë, dokumentat si më poshtë vijon:

1. Jetëshkrim të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të cilin e gjeni në link: <http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;
2. Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të Gjendjes Shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të Gjendjes Gjyqësore;
7. Vlerësimin e fundit në punë;
8. Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.
9. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
10. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucion brenda datës 21.08.2019

3. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Drejtoria e Burimeve Njerëzore në KLP do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Lëvizjes Paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e Lëvizjes Paralele të përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të njoftohen në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës së e-mail.

4. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të vlerësohen kandidatët

Kandidatët që konkurojnë për pozicionin e “Përgjegjës, në Sektorin e IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve”, do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
2. Njohuri mbi Ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
3. Njohuri mbi Ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar.
4. Njohuri mbi Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
5. Njohuri mbi legjislacionin për krimin kibernetik (ëëë.akshi.gov.al/Legjislacioni).
6. Rregullore për përdorimin e postës elektronike në administratën publike.

7. Legjislacioni në fuqi në lidhje me sigurinë e informacionit (<https://cesk.gov.al/legjislacioni/index.html>)

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Vlerësimi me shkrim sipas fushës së njohurive, **deri në 60 pikë**
2. Intervista e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, **deri në 25 pikë**
3. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, **deri në 15 pikë.**

6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, do të shpallet fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në faqen zyrtare të Institucionit. Të gjithë kandidatët pjesmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.